

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen e inicuar me padinë e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr. "[REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR], të cilin me autorizim e përfaqëson avokati [REDAKTUAR] nga Ferizaj, kundër të paditues Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, për shkak të kompensimit të tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, me datë 29.09.2017, jashtë seancës ka marrë këtë:

**A K T G J Y K I M**  
*– pa shqyrtim kryesor te çështjes –*

- I. **APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, e ushtruar kundër të paditues Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, për shkak të kompensimit të tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.
- II. **OBLIGOHET** e paditura Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, që në emër të kompensimit të tri pagave mujore dhe tri pagave jubilarë t'ia paguaj paditësit shumën prej **2,699.10 €**, me kamatën e cila do të llogaritet sipas lartësisë që aplikojnë bankat vendore për deponimet e rëndomta të qytetarëve, për periudhë afatizuese një vjeçare, nga data e nxerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- III. **OBLIGOHET** e paditura t'ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës gjyqësore si dhe shpenzimet e përfaqësimit për avokat sipas tarifave të përfaqësimit të përcaktuara nga OAK-së.

**A r s y e t i m i**

Paditësi ka ushtruar padi kundër të paditues me datën 27.06.2017, me kërkesën për kompensimin e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë pas daljes në pension.

Gjykata, pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka obliguar të padituren që t'a parashtron përgjigjen në padinë e paditësit. E paditura në përgjigjen e saj në padi, ka kundërshtuar kërkespadinë duke theksuar se paditësi nuk ka sjellur prova që dëshmojnë se paditësi i ka shtjerrur të gjitha mjetet për realizimin e të drejtës së tij. Poashtu thekson se afati për të kërkuar kompensimin e pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë është parashkruar. Mëtej në përgjigjen në padi Drejtoria thekson se, sa i përket pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë, drejtoria e arsimit nuk ka paraparë një fond të tillë për kompensimin e tyre.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë: Kontrata e punës nr.446 e dt. 31.03.2015; libreza e punëtorit nr.4584/74 e vitit 1974; Shkresa zyrtare nr.250 e datës 19.04.2017; Vendimi nr.07-120/02-0052928/17 i datës 13.06.2017; Vendimi i datës 20.04.2017; Shkresa zyrtare nr.529 e datës 28.08.2017; lista e 3 pagave të fundit të [REDAKTUAR]

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditëses se ka përvojën e punës mbi 30 vjet.

Me leximin e Kontratës së punës dhe librezës së punëtorit nr.4584/74 e vitit 1974 Gjykata ka konstatuar se paditësi ka punuar te e paditura nga viti 1975 e deri në momentin e pensionimit me datë 30.03.2017. Me leximin e Shkresës zyrtare nr.250 të datës 19.04.2017 Gjykata ka konstatuar se paditësit i është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë; me leximin e vendimit nr.07-120/02-0052928/17 i datës 13.06.2017 paditësit i është refuzuar ankesa për kompensim të pagave përcjellëse dhe atyre jubilarë; me leximin e Shkresës zyrtare me nr. protokolli: 529 e datës 28.08.2017 Gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesataren e pagës në shumë prej 1,315.26 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për tri pagat jubilarë në shumën prej 1,315.26 € si dhe tri pagave përcjellëse shumën prej 1,315.26 € është bazuar në shkresën zyrtare nr.529 të datës 28.08.2017 të lëshuar nga e paditura, të cilën në gjykatë e ka dorëzuar paditësi, nga ku vërtetohet se paditësi në muajt e fundit para daljes në pension dhe atë në muajin janar ka pranuar pagën mujore 438.42 €, në muajin shkurt ka pranuar 438.42 €, dhe në muajin mars ka pranuar 438.42 €, e që gjithësej kap shifrën 1,315.26 €.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015, ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin ku ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të Kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi, i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, se shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5 t'ia paguajë tri paga jubilarë pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë qoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 36 par. 10 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë të pandryshuara, secila nga 438.42 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësja kërkesën për kompensimin e pagave përcjellëse duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për Gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë Kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Kurse sa i përket asaj që pagat jubilarë janë të parashkruara pasi që në nenin 36 par. 9 pika 9.5 kjo bëhet brenda një muaji për çdo 10 vite, ku paditësja ka bërë dhe në atë kohë është dashur të realizohen këto të drejta.

Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi parashkrim, pasi që sipas nenit 36 par. 9, thuhet qartë se për të përfituar paga jubilarë punëtorët e SBSHK-ut, në rastin konkret paditësi duhet që fillimisht të dalë në pension që të përfitojë shpërblimin jubilar e jo në kohën sa është në marrëdhënie pune, respektivisht kur i ka bërë 10 vite përvojë pune, 20 apo 30 vite, siç parashihet me këtë nen 36 par. 9 pika 9.1, 9.2 dhe 9.3.

Se pretendimi i përfaqësuesit është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit pasi që kjo është rregulluar me dispozitat ligjore të ligjit të punës nr. Ligji 03/L-212 dhe çështja e parashkrimit është e rregulluar me nenin 87 dhe ky afat nuk mundet të ndryshohet me marrëveshje në mes të palëve, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me zbatimin e institutit të parashkrimit është edhe për faktin se në nenin 36 par. 9 pika 9.4, thuhet decidivisht se punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpenzimin jubilar, e që në rastin

konkret rezulton se paditësja ka dal në pension tek e paditura dhe kjo ka për obligim që të i paguajë paditëses 3 paga jubilarë.

Nga sa u tha më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 152 të LPK-së, lidhur me nenin 36 par.9 dhe par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar nr.18 e datës 11.04.2014 dhe nenit 87 të Ligjit nr.03/L-2012 të Punës në Kosovë.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.522/17, me datën 29.09.2017



**KËSHILLË JURIDIKE;** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

- Acnr. 1963/18

07 12 20 18

